



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 57

18 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 257, datë 6.3.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1081, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”..... 2469
Vendim i KM nr. 259, datë 27.3.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Lumzi” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 2470
Vendim i KM nr. 260, datë 27.3.2013	Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave..... 2471
Vendim i KM nr. 261, datë 3.4.2013	Për emërim në detyrë..... 2478
Vendim i KM nr. 262, datë 3.4.2013	Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”..... 2478
Vendim i KM nr. 263, datë 3.4.2013	Për përcaktimin e çakmakëve rezistentë ndaj fëmijëve dhe çakmakëve me modele imituese, tërheqës ndaj fëmijëve..... 2499
Vendim i KM nr. 265, datë 3.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 2502
Vendim i KM nr. 266, datë 3.4.2013	Për pagesën e kështit të pestë të shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A. kundër Republikës së Shqipërisë” 2503

Vendim i KM nr. 267, datë 3.4.2013	Për disa ndryshime dhe një shtesë në vendimin nr. 24, datë 9.1.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit, në programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012-2013”.....	2503
Vendim i KM nr. 268, datë 3.4.2013	Për rishpërndarje fondesh brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e vitit 2013.....	2504
Vendim i KM nr. 271, datë 3.4.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të trageteve në portin e Durrësit	2505
Vendim i KM nr. 272, datë 3.4.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien për përdorim me koncesion të burimit ujor “Sasaj” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “Blue Eye One”.....	2505

VENDIM
Nr. 257, datë 6.3.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1081, DATË 21.10.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 pika 3, 51 e 56 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 61 pika 7, 64 pikat 2 e 5 dhe 65 pika 3 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1081, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin fjalët “... mbrojtjes së shëndetit të Kafshëve...” hiqen.

2. Në kreun I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1 Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së është kryeinspektori për fushën përkatëse të inspektimit. Ai është titullari i institucionit, përfaqëson AKU-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin e koordinimin e funksionimin, si dhe për cilësinë e efektivitetin e veprimtarisë së AKU-së.

1/2 Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së i raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, si dhe, kur ministri ka përcaktuar shprehimisht me urdher, i raporton edhe një njësie tjetër raportimi në aparatin e ministrisë përgjegjëse.

b) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i) Shkronja “a” riformulohet si më poshtë vijon:

“a) Bashkërendon kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, të mbrojtjes së bimëve, të drejtave të seleksionerit të bimëve, të veprimtarive për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve, si dhe të fushës së veprimtarisë së prodhimit e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, sipas planifikimeve të kontrollit, të përcaktuara në legjislacionin e fushës përkatëse, si dhe të atij për inspektimin;”.

ii) Në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “ë”, në fund të çdo paragrafi, shtohen fjalët “... të kontrollit për zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes të drejtave të seleksionerit të bimëve, fushën e veprimtarive për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve, si dhe në fushën e veprimtarisë së prodhimit dhe tregtimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor.”.

c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1, 4/2 dhe 4/3 me këtë përmbajtje:

“4/1. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme është përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme për të gjithë institucionin:

a) menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse;

b) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

4/2. Në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së krijohet Komisioni i Ankimit të AKU-së, i cili drejtohet nga kryeinspektori dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;

b) një përfaqësues nga sektori përkatës që mbulon çështjen e inspektimit që ankimohet;

c) dy specialistë të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme.



4/3. Lista emërore e Komisionit të Ankimit miratohet me urdhër të kryeinspektorit dhe bëhet publike me mjete të përshtatshme.”.

ç) Në fjalinë hyrëse të pikës 5 fjalët “...drejtori rajonal...” zëvendësohen me “...kryeinspektori rajonal...”.

d) Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1, 8/2 dhe 8/3 me këtë përmbajtje:

“8/1. Kryeinspektori rajonal përfaqëson drejtorinë rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin e koordinimin e funksionimin, si dhe për cilësinë e efektivitetin e veprimtarisë së drejtorisë.

8/2. Përveç sa parashikohet në pikën 5 të këtij vendimi, kryeinspektori rajonal:

a) lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;

c) vendos për zëvendësimin e inspektorëve, gjatë inspektimit, sipas ligjit;

ç) shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët e drejtorisë përkatëse.

8/3. Kryeinspektori rajonal i raporton dhe i jep llogari drejtpërdrejt drejtorit të përgjithshëm të AKU-së, kryeinspektorit, përveçse kur ai ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 259, datë 27.3.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LUMZI” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 pika 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Lumzi” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikëve për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese, për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “M.C.Inerte” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Lumzi”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 260, datë 27.3.2013

**PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN, MARRJEN E MOSTRAVE,
ANALIZAVE E TË PROCEDURAVE, DHËNIEN E REZULTATEVE TË TYRE, SI DHE
VLERËSIMIN E ANALIZAVE TË PLEHRAVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për:

- a) kryerjen e kontrollit zyrtar dhe të procedurave të marrjes së mostrës së plehrave;
- b) kryerjen e analizave për verifikimin e treguesve cilësorë të deklaruar në certifikatën e analizës e të origjinës;
- c) dhënien e rezultateve të analizave dhe vlerësimin e tyre.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm do të kuptohen:

- a) “Gjurmim”, ndjekja e plehut gjatë gjithë fazave të përshkuara, që nga prodhimi deri në vendosjen e tij në treg, nëpërmjet procedurës së ruajtjes së informacionit të përmbajtur në dokumentacionin shoqërues;
- b) “Etiketa e mostrës”, modeli i shkruar, që plotësohet nga inspektori me të dhënat që kërkohen për identifikimin e mostrës për kryerjen e analizave zyrtare;
- c) “Kod identifikimi”, një numër që vendoset nga inspektori për të ruajtur identitetin e prodhuesit;
- ç) “Format e përbërjes së plehrave”, forma të përbërjes kimike të çdo elementi ushqyes të deklaruar dhe të paraqitura në etiketën e paketimit, certifikatën e origjinës ose dokumentet origjinale shoqëruese të plehut.

II. KONTROLLI, MARRJA DHE DORËZIMI I MOSTRËS

A. Rregulla të përgjithshme për kontrollin dhe marrjen e mostrave

1. Kontrolli dhe marrja e mostrave për analizimin e plehut bëhet nga inspektori, i cili, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, identifikohet me kartën e inspektorit, të lëshuar në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Inspektori merr mostrën e plehrave me vendosjen në treg të tyre, në të gjitha rastet kur mendon se ka tjetërsim, ndryshim të vetive fiziko-kimike të tyre.

¹ Pjesërisht e përputhshme me Rregulloren e Bashkimit Europian 2003/2003 “Për plehrat”, e Parlamentit dhe Këshillit, datë 13 tetor 2003. Numri Celex. 32003 R 2003, Fletorja Zyrtare nr. 304, datë 21.11.2003, faqe 0001-0194.



3. Inspektori gjykon dhe vendos për treguesit cilësorë, të cilët do t'u nënshtrohen analizave që do të kryhen në laboratorët e miratuar.

B. Marrja dhe dorëzimi i mostrës

1. Marrja e mostrave për analizim, si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve kryhet sipas përcaktimit të dhënë në nenin 38 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Procedurat e hollësishme për marrjen dhe trajtimin e mostrave të plehrave bëhen sipas metodikave të përcaktuara në standardet përkatëse të adoptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.

3. Përgatitja e mostrës bëhet si më poshtë vijon:

a) Inspektori merr tri mostra;

b) Mostrat vendosen në mbajtëse plastike. Secila mostër e marrë vendoset në një mbajtëse tjetër të dytë plastike. Ndërmjet mbajtëses së parë dhe asaj të dytë vendoset etiketat e mostrës, që plotësohet nga inspektori, sipas përcaktimit të shtojcës 2 të këtij vendimi. Në prani të prodhuesit, mbajtëset plastike mbyllen dhe plumbosen në mënyrë të tillë, që hapja e tyre të çojë në dëmtimin e pandreqshëm të plumbosjes;

c) Për të ruajtur anonimin e mostrës, inspektori vendos një kod identifikimi tek etiketa. Ky kod identifikimi i përket prodhuesit të plehut dhe regjistrohet nga inspektori duke u mbajtur i fshehtë deri në kthimin e përgjigjes së analizave zyrtare;

ç) Prishja e plumbosjes së mostrës bëhet në momentin e dorëzimit në laborator, në prani të inspektorit dhe marrësit në dorëzim;

d) Çdo mostër shoqërohet me procesverbal inspektimi, sipas përcaktimit të dhënë në shtojcën 1 të këtij vendimi. Procesverbali i inspektimit, mbahet në momentin e marrjes së mostrës dhe në prani të prodhuesit ose përfaqësuesit të tij;

dh) Mostra për analizat e përbërësve cilësorë të plehut regjistrohet në protokollin e marrjes në dorëzim të mostrave, të përcaktuar në shtojcën 3 të këtij vendimi.

4. Dorëzimi i mostrës bëhet si më poshtë vijon:

a) inspektori dorëzon njërën nga tri mostrat në laboratorin e miratuar brenda 3 (tre) ditëve nga momenti i marrjes së saj, në mënyrë që të mos ketë ndikim në ndryshimin e vetive fiziko-kimike të mostrës;

b) mostra e dytë ruhet nga inspektori derisa të përfundojnë procedurat e verifikimit dhe ballafaqimit të rezultateve të analizave të kërkuara prej tij;

c) mostra e tretë mbahet nga prodhuesi, për ankim ose jo të rezultateve të analizave.

III. ANALIZAT DHE PROCEDURAT

1. Analizat e plehrave, si dhe procedurat laboratorike bëhen sipas metodikave të përcaktuara në standardet përkatëse, të adoptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.

2. Pas përfundimit të analizave, rezultatet e tyre regjistrohen në dy mënyra:

a) manuale, në regjistrat e laboratorit;

b) kompjuterike, nga përgjegjësi i laboratorit te plotësimi i fletanalizës, sipas përcaktimit të dhënë në shtojcën 4 të këtij vendimi.

3. Fletanaliza me të dhënat e rezultateve plotësohet në tri kopje, sipas kërkesave të inspektorit, të përcaktuar në procesverbalin e inspektimit. Secila kopje firmoset nga analizuesi, përgjegjësi i laboratorit dhe titullari.

IV. REZULTATET E ANALIZAVE LABORATORIKE

A. Dhënia e rezultateve të analizave

1. Rezultati përfundimtar i analizave për plehrat dorëzohet sipas afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011.

2. Një kopje e fletanalizës, sipas pikës 3 të kreut III, ruhet në laboratorin ku janë kryer analizat, kopja e dytë ruhet në arkivin e institucionit ku bën pjesë laboratori dhe kopja e tretë i dorëzohet inspektorit.

3. Dokumentacioni përkatës që shoqëron mostrën dhe analizat, ruhet në laborator për një afat kohor deri në një vit dhe pastaj arkivohet.

B. Vlerësimi i rezultateve të analizave

1. Vlerësimi i përputhshmërisë me përshtatshmërinë e llojeve të plehrave, si dhe me përmbajtjen e deklaruar të ushqyesve dhe/ose përmbajtjen e deklaruar të formave apo të tretshmërisë së këtyre ushqyesve, kryhet nga inspektori, në këtë mënyrë:

a) vlerësohen plehrat, në bazë të ballafaqimit të rezultateve të analizave të kryera për mostrën, sipas kërkesave të bëra, me treguesit e deklaruar në etiketë ose në certifikatën e analizave e të origjinës;

b) vlerësohet nëse një pleh është me mungesa në përmbajtjen e elementeve ushqyese ose përmban elemente të dëmshme për njerëzit, kafshët dhe mjedisin;

c) brenda katër ditëve nga dita e marrjes së përgjigjes së analizave, inspektori njofton prodhuesin në mënyrë elektronike, për vlerësimin e rezultateve dhe, më pas, i dorëzon kopjen e rezultateve të analizave.

2. Kur të dhënat e specifikuara në certifikatën e analizës e të origjinës së plehut, nuk përputhen me analizat laboratorike, veprohet sipas nenit 7 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011.

3. Kur një prodhues nuk është dakord me rezultatet e analizave, brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh bëhet ballafaqimi me laboratorin që ka kryer analizat. Edhe pas ballafaqimit me laboratorin, nëse prodhuesi përsëri nuk është dakord me rezultatet e analizave, atëherë ato kryhen në laboratorin e referencës, të përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011.

4. Për të siguruar gjurmimin e plehrave të vendosura në treg, përfshirë edhe nitratin e amonit me përmbajtje të lartë azoti, prodhuesi duhet të ruajë emrat dhe adresat e vendeve ku është prodhuar plehu, si dhe të dhënat e certifikatës së origjinës e të analizave, të përcaktuara sipas etiketës. Këto të dhëna janë objekt inspektimi, për sa kohë që plehu vendoset në treg, si dhe për një periudhë prej 2 vitesh, pas përfundimit të vendosjes në treg të këtij plehu nga prodhuesi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, përgjegjës për marrjen e mostrave, si dhe laboratorët e akredituar e të miratuar për kryerjen e analizave të plehut, të mbajnë lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, për njohjen e metodave të adaptuara dhe të miratuara prej saj, bazuar në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe laboratorët e miratuar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Shtojca 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. _____

Datë / /2013

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Qarku.....

PROCES - VERBAL INSPEKTIMI

Në zbatim të ligjit nr.10390, datë 03.03.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", si dhe në VKM nr....., datë "Rregullat për kontrollin, marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre si dhe vlerësimi i analizave të plehrave", gjatë kontrollit u konstatua:

- 1.....
- 2.....
3. Mora mostër për analiza të cilësisë së plehut.....

Kodi i subjektit prodhues (.....)

(Ky kod nuk vendoset në proces-verbalin e inspektimit që dorëzohet dhe ruhet tek prodhuesi)

Mora gjithsej 3 (tre) mostra dhe do të kryej këto analiza:

- Lloji i analizave që kryhen do t'i përmbahet të dhënave sipas etiketës të vendosur në paketimin e plehrave ose certikatën e origjinës si dhe dokumentave origjinale shoqëruese.

- Analizat kryhen në laboratorin e miratuar :.....

- Analiza kimike.....

- Karakteristikat cilësorë (ngjyra, përbërja granulorë, kristalore, pluhur dhe i lëngshëm ose forma të tjera).....

Bazuar në sa më lart vendosa:.....

(Ky proces-verbal inspektimi mbahet në tre kopje. Njëra kopje i dorëzohet prodhuesit, një e merr inspektori dhe kopja e tretë, dorëzohet në laboratorin e analizave.

Në proces-verbalin e inspektimit që shoqëron mostrën për analiza, nuk vendoset emri i prodhuesit ose subjekti, por vetëm firma e përfaqësuesit.)

Prodhuesi ose Përfaqësuesi
(.....)

Inspektorët
(.....)

Shtojca 2

ETIKETA E MOSTRËS SË PLEHRAVE

- | | |
|--|--|
| 1. Kodi i prodhuesit
(.....) | 2. Emri i plehut.
(.....) |
| 3. Tipi i plehrave dhe forma e përbërjes
(.....) | 4. Data e marrjes së mostrës.
(.....) |
| 5. Adresa dhe nr. telefonik i Prodhuesit.
(.....) | 6. Adresa dhe nr. telefonik i Inspektorit
(.....) |
| 7. Qarku..... | |
| 8. Numri i standardit që është përdorur për marrjen e mostrës..... | |

Në etikën e mostrës që dorëzohet në laboratorin e miratuar për analiza, nuk shënohet, adresa dhe numri telefonik i prodhuesi .

Në etiketën e mostrës që mban prodhuesi, nuk shënohet kodi i prodhuesit .

Emri, mbiemri i inspektorit (.....)

Firma ,Vula (.....)



Shtojca nr. 3

LABORATORI I ANALIZAVE TË PLEHRAVE

.....

PROTOKOLLI I MARRJES NË DORËZIMIT TË MOSTRAVE TË PLEHRAVE

Lista me nr.....Datë.....201....

Emri/ Mbiemri i inspektorit :

Kodi i mostrës së dorëzuar

Numri i mostrave.....

Lloji i plehut

Tipi i plehut.....

Lloji i Analizave;.....

.....

.....

Dorëzuesi i mostrave

Marrësi në dorëzim

(.....)

(.....)

Numri i serisë së protokollit për dorëzimin e mostrave mbahet në mënyrë progresive.

Shtojca nr. 4

LABORATORI I ANALIZAVE TË PLEHRAVE

Nrprot.

Datë / /2013

FLETË – ANALIZE

Mbështetur në VKM nr....., datë “Rregullat për kontrollin, marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre si dhe vlerësimi i analizave të plehrave” rezultojn: se:

Sipas proces-verbalit të inspektimit, me inspektor z/znj.....
Qarku.....

Kryem analizat laboratorike të plehut.....

Dorëzuar më datën.....me kodin

Treguesit e analizuar:

Njesia matëse

Rezultat e analizave

1.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Analizuesi

.....

Përgjegjësi i Laboratorit

.....

Titullari

.....



VENDIM
Nr. 261, datë 3.4.2013

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Bardh Spahia të emërohet Zëvendësministër i Shëndetësisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 262, datë 3.4.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR SIGURINË E LODRAVE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Efektet e zbatimit të tij fillojnë më 1 qershor 2015.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Direktiva 2009/48/EC e Parlamentit Europian, e datës 1 mars 2012 “Për sigurinë e lodrave” EUR-Lex, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L 170 e datës 30.6.2009.

RREGULL TEKNIK

PËR

SIGURINË E LODRAVE

1. Dispozita të përgjithshme

1.1. Objekti

Ky Rregull Teknik përcakton rregullat mbi sigurinë e lodrave dhe lëvizjen e lirë të tyre në tregun shqiptar.

1.2. Fusha e veprimit

1.2.1. Ky Rregull Teknik zbatohet për produkte të dizenuara ose të parashikuara për t'u përdorur në lojë, por edhe kur nuk janë ekskluzivisht të parashikuara vetëm për qëllime loje, nga fëmijë nën moshën 14 vjeç (më poshte referohen si lodra).

Produktet e listuara në pikën 7 nuk konsiderohen si lodra në kuptim të këtij Rregulli Teknik.

1.2.2. Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për lodrat e mëposhtme:

- a) pajisje të parashikuara për përdorim publik në parqe lojrash;
- b) makina automatike loje, të parashikuara për përdorim publik dhe që funksionojnë me ose pa monedhë metalike,
- c) lodra tip automjeti e pajisur me motor me djegje të brendshme;
- ç) lodra me motor me avull; dhe
- d) hedhësa dhe katapulta.

1.3. Përkufizime

Për qëllime të këtij Rregulli Teknik zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) “produkt funksional” është produkti që funksionon dhe përdoret në të njëjtën mënyrë si një produkt, pajisje ose instalim i parashikuar për përdorim nga të rritur dhe i cili mund të jetë një model i ngjashëm me përmasa proporcionale të këtij produkti, pajisjeje ose instalimi;
- b) “lodër funksionale” është një lodër që funksionon dhe përdoret në të njëjtën mënyrë si një produkt, pajisje ose instalim i parashikuar për përdorim nga të rriturit dhe që mund të jetë një model i ngjashëm me përmasa proporcionale të këtij produkti, pajisjeje ose instalimi;
- c) “lodër ujore” është një lodër e parashikuar të përdoret në ujra të cekta dhe që është në gjëndje të mbajë ose të çvendosë një fëmijë mbi ujë;
- ç) “shpejtësi e projektuar” është shpejtësia përfaqësuese potencialisht funksionale që është përcaktuar nga projektimi i lodrës;
- d) “lodër aktivizuese” është një lodër për përdorim shtëpiak ku struktura mbështetëse mbetet e palëvizëshme gjatë aktivitetit dhe është parashikuar që një fëmijë të kryejë një nga aktivitetet e mëposhtme: ngjitje, kërcim, lëkundje, rrëshqitje, përkundje, rrotullim, zvarritje dhe kacavirrje ose çdo kombinim të tyre;
- dh) “lodër kimike” është një lodër e parashikuar për trajtim të drejtpërdrejtë të substancave dhe përzjerjeve kimike dhe për përdorim në një mënyrë të përshtatshme për një grup moshe të dhënë dhe nën mbikqyrjen e një të rrituri;
- e) “lojë për shqisat e nuhatjes” është një lodër, qëllimi i të cilës është të ndihmojë një fëmijë që të mësojë të njohë erërat ose aromat.



- ë) “kuti kozmetike” është një lodër qëllimi i të cilës është të ndihmojë një fëmijë që të mësojë të bëjë produkte, të tilla si aromatizantë, sapune, kremra, shampo, sfungjerë larës, shkëlqyes, të kuq buzësh, pasta dhëmbësh dhe kremra qetësues;
- f) “lojë gatimi” është një lodër qëllimi i të cilës është të lejojë fëmijët të bëjnë ëmbëlsira ose gatime të tjera që përfshijnë përdorimin e përbërësve ushqimorë si ëmbëlsira, lëngje dhe aromatizantë;
- g) “dëmtim” është plagosje fizike ose çdo dëmtim tjetër në shëndet, duke përfshirë dhe pasojat afatgjate të shëndetit;
- gj) “rrezik” është një burim potencial për dëmtim;
- h) “risk” është shkalla e mundshme e shfaqjes së një rreziku që shkakton dëmtim dhe dëmtim të një shkalle të lartë;
- i) “i parashikuar për përdorim nga” nënkupton që një prind ose mbikqyrës, në mënyrë të arsyeshme është në gjëndje të supozojë në bazë të funksioneve, dimensioneve dhe karakteristikave të lodrës, që ajo është parashikuar të përdoret nga fëmijë i një grupi të deklaruar moshe.

2. Detyrimet e operatorëve ekonomikë

2.1 Prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EC të konformitetit për një periudhë prej 10 vjetësh mbasi lodra është vendosur në treg në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse.

2.2 Përfaqësuesi i autorizuar mban deklaratën EC të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për një periudhë së paku 10 vjet pasi lodra është vendosur në treg;

2.3 Importuesi, për një periudhë 10 vjeçare mbasi lodra është vendosur në treg, duhet të mbajë në dispozicion të strukturës përgjegjëse një kopje të deklaratës EC të konformitetit dhe të sigurojë, sipas një kërkesë, që dokumentacioni teknik është i vlefshëm për atë

2.4. Identifikimi i operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë, sipas një kërkesë të strukturës përgjegjëse, duhet të identifikojnë çdo operator ekonomik:

a) i cili ka furnizuar atë me një lodër,

b) të cilit ai i ka furnizuar një lodër,

Operatorët ekonomikë, në rastin e prodhuesit, duhet të jenë në gjëndje të paraqesin informacionin e referuar në nënpikën a) për një periudhë prej 10 vjetësh mbasi lodra është vendosur në treg dhe, në rastin e operatorëve të tjerë ekonomik, për një periudhë prej 10 vjetësh mbasi ata kanë furnizuar një lodër.

3. Përputhshmëria e lodrave me kërkesat thelbësore të sigurisë

3.1. Kërkesa thelbësore të sigurisë

a) Lodrat vendosen në treg vetëm nëse plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara, për sa i përket kërkesës së përgjithshme të sigurisë referuar në paragrafin (b) dhe për sa i përket kërkesave të veçanta të sigurisë të dhëna në pikën 8.

b) Lodrat, duke përfshirë dhe kimikatet që ato përmbajnë, nuk duhet të rrezikojnë sigurinë ose shëndetin e përdoruesëve ose palëve të treta kur ato përdoren si janë përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, duke patur parasysh edhe sjelljen e fëmijeve.

Aftësia e përdoruesve dhe sipas rastit, e mbikqyrësve të tyre duhet të merret në konsideratë, veçanërisht në rastin e lodrave të cilat janë parashikuar të përdoren nga fëmijë nën 36 muaj ose nga grupe të tjera të specifikuara moshash.

Etiketat e vendosura në përputhje me pikën 3.2(b) dhe instruksionet e përdorimit që shoqërojnë lodrat duhet të tërheqin vëmendjen e përdoruesëve ose mbikqyrësve të tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme të dëmtimit që përfshihen gjatë përdorimit të lodrave si dhe mënyrat mbi shmangiet e rreziqeve dhe risqeve të tilla.

c) Lodrat e vendosura në treg duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë gjatë periudhës së parashikuar të përdorimit normal të tyre.

3.2. Paralajmërimet

a) Sipas rastit, për përdorim të sigurtë, paralajmërimet e bëra për qëllime të pikës 3.1(b) duhet të specifikojnë kufizimet e përshtatshme në përdorim në përputhje me pikën 9.1.

Për kategoritë e lodrave të listuara në pikën 9.2 përdoren paralajmërimet e dhëna në këtë pikë. Paralajmërimet e dhëna nga pikat 8.2.2 deri në pikën 8.2.10 përdoren si janë aty.

Lodrat nuk duhet të mbajnë një ose më shumë nga paralajmërimet specifike të dhëna në pikën 9.2 kur ky paralajmërim bie ndesh me përdorimin e parashikuar të lodrës, si përcaktohet në bazë të funksionit, përmasave dhe karakteristikave të saj.

b) Prodhuuesi duhet të shënojë paralajmërimet në një mënyrë qartësisht të dukshme, lehtësisht të lexueshme, të kuptueshme dhe të saktë në lodër, në një etiketë të fiksuar mbi lodër, ose mbi paketim dhe, nëse kërkohet, në instruksionet e përdorimit të cilat shoqërojnë lodrën.

Lodrat e vogla të cilat shiten pa paketim duhet të kenë të fiksuar mbi to paralajmërimet përkatëse.

Paralajmërimet duhet të paraprihen nga fjalët “Paralajmërim” ose ‘Paralajmërim’, sipas rastit.

Paralajmërimet, të cilat përcaktojnë një kusht për të blerë lodrën, të tilla si ato që specifikojnë moshat minimale dhe maksimale të përdoruesit si dhe paralajmërimet e tjera të dhëna në pikën 8, duhet të duken në paketimin për konsumatorit ose duhet të jenë qartësisht të dukshme për konsumatorin përpara shitjes, duke përfshirë dhe rastet kur shitja bëhet online.

c) Paralajmërimet dhe instruksionet e sigurisë duhet të jenë në shqip.

3.3. Lëvizja e lirë

Nuk pengohet bërja e disponueshme në tregun shqiptar e lodrave që janë në përputhje me këtë Rregull Teknik.

3.4. Prezumimi i konformitetit

Lodrat që janë në konformitet me standardet e harmonizuara ose në pjesë të tyre, referimet e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat e mbuluara nga këto standarde ose pjesë të tyre me kërkesat e dhëna në pikat 3 dhe 8.

3.5. Kundërshtimi formal për një standard të harmonizuar

Kur konsiderohet se një standard i harmonizuar shqiptar nuk plotëson tërësisht kërkesat që ai mbulon dhe të cilat janë të dhëna në pikën 3 dhe 8, struktura përgjegjëse referuar në ligjin nr 10489, datë 15.12.2012 ‘Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore’ dhe/ose ministria përgjegjëse dërgon çështjen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit duke dhënë opinionin e vet/tyre.

3.6. Parime të përgjithshme mbi markimin CE

a) Lodrat e bëra të disponueshme në tregun shqiptar duhet të kenë markimin CE.

b) Lodrat që mbajnë markimin CE prezumohen se janë në përputhje me këtë Rregull Teknik.

c) Lodrat të cilat nuk kanë të vendosur markimin CE ose që nuk janë në përputhje me këtë Rregull Teknik mund të tregohen dhe të përdoren në panairë tregtare dhe ekspozita, vetëm me kushtin që ato të jenë të shoqëruara nga një shënim, i cili qartësisht tregon se ato nuk janë në përputhje me këtë Rregull Teknik dhe që nuk mund të bëhen të disponueshme në treg pa u sjellë në konformitet.




3.7. Rregullat dhe kushtet e vendosjes së markimit CE

a) Markimi CE vendoset në lodër në një etiketë të fiksuar në lodër ose në paketimin e saj në mënyrë të dukshme, të lexeshme dhe të paheqëshme.

Në rastin e lodrave të vogla dhe lodrave që përbehen nga pjesë të vogla, markimi CE mund të vendoset në mënyre alternative në etiketë ose në fletëpalosjen shoqëruese.

Në rastin e lodrave të shitura në ekspozita ku teknikisht është e pamundur, markimi CE mund të vendoset në ekspozitorin, me kusht që ekspozitori fillimisht të jetë përdorur si paketim për lodrën.

b) Markimi i konformitetit CE përbëhet nga inicialet 'CE' në formën e mëposhtme:



Markimi CE duhet të jetë të paktën 5 mm i lartë. Në rast se markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, përmasat e dhëna në vizatimin e shkallëzuar më lart duhet të respektohen.

4. Vlerësimi i konformitetit

4.1. Vlerësimi i sigurisë

Prodhuksi, përpara vendosjes në treg të një lodre, duhet të kryejë analizën mbi rreziqet kimike, fizike, mekanike, elektrike, ndezshmërinë, higjienike dhe radioaktive, që lodra mund të paraqesë, si dhe vlerësimin mbi ekspozimin potencial të këtyre rreziqeve.

4.2. Proçedurat e vlerësimit të konformitetit

4.2.1. Prodhuksi, përpara vendosjes të një lodre në treg, për të demonstruar se lodra është në përputhje me kërkesat e dhëna në pikat 3. dhe 8, duhet të përdorë proçedurat e vlerësimit të konformitetit të referuara në pikat 4.2.2, 4.2.4 dhe 4.2.5.

4.2.2. Nëse prodhuksi ka zbatuar standarde të harmonizuara, referimet e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, që mbulojnë të gjitha kërkesat përkatëse të sigurisë për lodrën, ai duhet të përdorë proçedurën e kontrollit të brendshëm të prodhimit sipas modulit A, si më poshtë:

Moduli A Kontrolli i brendshëm i prodhimit

a) Kontrolli i brendshëm i prodhimit është pjesa e proçedurës së vlerësimit të konformitetit, në të cilën prodhuksi përmbush detyrimet e dhëna në pikat b) dhe c) të modulit A dhe siguron e deklaron nën përgjegjësinë e tij se produkti përmbush kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

b) Dokumentacioni teknik

Prodhuksi harton dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të riskut/risqeve.

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, për sa është relevante për vlerësim, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lodrës.

Dokumentacioni teknik përmban të paktën elementët e mëposhtëm:

- (i) një përshkrim të përgjithshëm të lodrës,
- (ii) vizatime/skica të projektimit fillestar dhe të prodhimit dhe skema të komponentëve, nën-bashkimeve/montimeve, qarqeve, etj,
- (iii) - përshkrime dhe shpjegime të nevojshme për të kuptuar këto vizatime, skema skica dhe funksionimin e lodrës,
- (iv) listën e standardeve të harmonizuara shqiptare/europiane dhe/ose specifikime të tjera teknike që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, referenca e të cilave është publikuar në fletoren zyrtare, si dhe përshkrimin e zgjidhjeve teknike të zbatuara për të plotësuar kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik kur nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara. Në rastin e zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik duhet të specifikojë pjesët të cilat janë zbatuar,
- (v) rezultatet e përllogaritjeve të bëra për projektimin/dizajnin, ekzaminimet/shqyrtimet e kryera, etj, dhe
- (vi) Raportet e testimit

c) Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe kontrollit të tij të sigurojnë përputhjen e lodrave të prodhuara me dokumentacionin teknik të dhënë në pikën b) të modulit A si dhe me kërkesat e këtij Rregulli-Teknik të zbatuara në to,

ç) prodhuesi vendos markimin e konformitetit në çdo lodër që plotëson kërkesat e zbatuara ligjore ndaj saj dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit për çdo model të lodrës dhe e mban atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të strukture përgjegjëse për 10 vjet mbasi lodra është vendosur në treg.

Deklarata e konformitetit identifikon lodrën për të cilën ajo është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit bëhet e vlefshme, sipas një kërkesë, për strukturën përgjegjëse të mbikqyrjes së tregut.

d) Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të dhëna në pikën ç) të modulit A mund të plotësohen nga përfaqësuesi i autorizuar në emër dhe nën përgjegjësinë e tij si të parashikuara në aktin e përfaqësimit.

4.2.3. Lodra i nënshtrohet procedurës së konformitetit në modulën B - shqyrtimit EC të tipit siç referohet në pikën 4.2.4 së bashku me procedurën e konformitetit me tipin mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit të dhënë në modulën C referuar në pikën 4.2.5, për rastet e mëposhtme

- a) kur nuk ekzistojnë standardet e harmonizuara që mbulojnë të gjitha kërkesat përkatëse të sigurisë,
- b) kur ekzistojnë standardet e harmonizuar të referuar në paragrafin a) të kësaj pike por prodhuesi nuk i ka zbatuar ose i ka zbatuar ato vetëm pjesërisht,
- c) kur një ose më shumë nga standardet e harmonizuar të referuar në paragrafin a) të kësaj pike janë publikuar me kufizime,
- ç) kur prodhuesi konsideron se natyra, projektimi, konstruksioni ose qëllimi i lodrës kërkon verifikim nga një palë e tretë.



4.2.4 Moduli B - Shqyrtimi EC i tipit

Shqyrtimi EC i tipit është pjesa e procedurës së vlerësimit të konformitetit, në të cilën një organizëm europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri shqyrton projektimin teknik të lodrës dhe verifikon dhe vërteton që lodra përmbush kërkesat ligjore ndaj tij.

a) Shqyrtimi EC i tipit kryhet në bazë të vlerësimit të përshtatshmërisë së projektimit/dizajnit teknik nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe evidencës mbështetëse, referuar në gërmën b) të Moduli B, si edhe shqyrtimit të mostrave, përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, për një ose më shumë pjesë kritike të lodrës (kombinimi i tipit të prodhimit me tipin e projektimit/dizajnit

b) prodhuesi paraqet aplikimin për shqyrtimin EC të tipit në një organizëm të vetëm europian të notifikuar ose degë të tij të regjistruar në Shqipëri.

Aplikimi përmban:

i) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse aplikimi është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e këtij të fundit,

ii) një deklaratë të shkruar që i njëjti aplikim nuk është paraqitur në një organizëm tjetër europian të notifikuar ose degë të tij në Shqipëri,

iii) një përshkrim të përgjithshëm të lodrës,

iv) dokumentacionin teknik. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të risqeve. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, për sa është relevante për vlerësim, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lodrës. Dokumentacioni teknik përmban të paktën elementët e mëposhtëm:

- një përshkrim të përgjithshëm të lodrës,

- vizatime/skica të projektimit fillestar dhe të prodhimit dhe skema të komponentëve, nën-bashkimeve/montimeve, qarqeve, etj

- përshkrime dhe shpjegime të nevojshme për të kuptuar këto vizatime, skema skica dhe funksionimin e lodrës,

- listën e standardeve të harmonizuara shqiptare/europiane dhe/ose specifikime të tjera teknike që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, referenca e të cilave është publikuar në fletoren zyrtare, si dhe përshkrimin e zgjidhjeve teknike të zbatuara për të plotësuar kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik kur nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara. Në rastin e zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik duhet të specifikojë pjesët të cilat janë zbatuar,

- rezultatet e përllogaritjeve të bëra për projektimin/dizajnin, ekzaminimet/ shqyrtimet e kryera etj,

- raportet e testimit

- mostra përfaqësuese të parashikuara të prodhimit. Organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri mund të kërkojë mostra të tjera në qoftë se është e nevojshme për kryerjen e programit të testimit,

- evidencë mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjeve teknike të projektimit/dizajnit. Kjo evidencë duhet të përmendë çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet e harmonizuara dhe/ose zgjidhjet teknike nuk janë zbatuar plotësisht. Evidenca mbështetëse duhet të përfshijë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në laboratorët e përshtatshëm të prodhuesit ose në laborator tjetër testues në emër të tij ose nën përgjegjësinë e prodhuesit.

c) Në lidhje me produktin, organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri shqyrton dokumentacionin teknik dhe evidencën mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit/dizajnit të lodrës.

ç) Në lidhje me mostrat, organi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri:

i) verifikon nëse mostrat janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik, identifikon elementët që janë projektuar në përputhje me standardet e harmonizuara dhe/ose specifitime teknike, si dhe elementët që janë projektuar pa zbatuar kërkesat përkatëse të këtyre standardeve,

ii) kryen shqyrtime dhe testime të përshtatshme për të kontrolluar se në rastin kur prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet në standardet e harmonizuara dhe/ose specifitime teknike, ato janë zbatuar korrektësisht,

iii) kryen shqyrtime dhe testime të përshtatshme për të kontrolluar se zgjidhjet teknike të zbatuara nga prodhuesi plotësojnë kërkesat thelbësore përkatëse të zbatueshme, në rastet kur prodhuesi nuk ka zbatuar zgjidhjet e standardeve të harmonizuara,

iv) bie në dakortësi me prodhuesin për vendin e kryerjes së shqyrtimeve dhe testeve.

d) Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri harton një raport që regjistron aktivitetet e ndërmara në përputhje me gërmat c) dhe ç) të modulit B dhe përfundimet e tyre. Pa kundërshtuar detyrimet e tij kundrejt autoritetit notifikues/miratues, ai njofton përmbajtjen e pjesëshme apo të plotë të këtij raporti, vetëm në marrëveshje me prodhuesin.

dh) Kur tipi (mostra/t përfaqësuese) plotëson kërkesat thelbësore të këtij Rregulli Teknik, organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri i lëshon prodhuesit certifikatën EC të shqyrtimit të tipit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e shqyrtimit, kushtet e vlefshmërisë nëse ka, dhe të dhëna të nevojshme për identifikimin e tipit të aprovuar. Certifikata mund të ketë një apo më shumë anekse bashkëlidhur saj.

Certifikata dhe anekset e saj duhet të përmbajnë gjithë informacionin përkatës që mundëson vlerësimin e përputhshmërisë së lodrave të prodhuara me tipin e shqyrtuar dhe të mundësojë kontrollin në shërbim.

Kur tipi nuk plotëson kërkesat e këtij Rregulli Teknik organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri refuzon lëshimin e certifikatës EC të shqyrtimit të tipit, duke informuar aplikantin dhe duke dhënë gjithë arsyet e refuzimit.

e) Organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri duhet të jetë i përditësuar me çdo ndryshim në gjendjen e përgjithshme të zhvillimit të teknologjisë, që mund të tregojë se tipi i aprovuar mund të ndikojë në përmbushjen e kërkesave thelbësore të këtij Rregulli Teknik dhe përcakton nëse këto ndryshime kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse ky është rasti, organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri njofton prodhuesin.

Prodhuesi informon organizmin e notifikuar europian ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën EC të shqyrtimit të tipit, për të gjitha modifikimet e tipit të miratuar që mund të ndikojë në përmbushjen e kërkesave thelbësore të këtij Rregulli Teknik ose kushtet për vlefshmërinë e certifikatës. Modifikime të tilla do kërkojnë provime të tjera shtesë në formën e një shtese në certifikatën EC fillestare të shqyrtimit të tipit.

ë) Organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri njofton organizmat e tjerë në lidhje me certifikatat EC të shqyrtimit të tipit dhe çdo shtesë në to në mënyrë periodike ose me kërkesë listën e këtyre certifikatave, shtesave në to, refuzimeve, pezullimeve ose kufizimeve.



Organizmi njofton organizmat e tjera të notifikuara në lidhje me refuzimin e lëshimit të certifikatave EC të shqyrtimit të tipit ose shtesave në to, tërheqjen, pezullimin apo kufizimin e tyre dhe sipas kërkesës edhe certifikatat e lëshuara.

Me kërkesë, Ministria dhe struktura përgjegjëse mund të mbajnë kopje të certifikatave EC të shqyrtimit të tipit si dhe kopje të dokumentacionit teknik dhe rezultatet e shqyrtimeve të kryera nga organizmi i notifikuar europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri, anekset e saj si dhe dokumentacionin teknik që përfshin dokumentacionin e dhënë nga prodhuesi deri në përfundimin e vlefshmërisë së certifikatës,

f) prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës, anekseve dhe shtesave të sajës bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve shtetërore (ministritë dhe strukturës përgjegjëse) për një periudhë 10 vjeçare pas vendosjes në treg të lodrës,

ë) kur një organizëm europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri për vlerësimin e konformitetit kryen shqyrtimin EC të tipit, ai duhet të vlerësojë, nëse është e nevojshme së bashku me prodhuesin, analizën që ka kryer prodhuesi në lidhje me rreziqet që mund të paraqesë lodra,

g) përfaqësuesi i autorizuar mund të paraqesë aplikimin referuar në gërmën b) të modulit B dhe përmbush detyrimet referuar në gërmat dh) dhe e), të këtij moduli kur ato janë specifikuar në mandatin e tij,

gj) certifikata EC e shqyrtimit të tipit përfshin gjithashtu referimin në këtë Rregull Teknik/direktivën përkatëse europiane për sigurinë e lodrave, një fotografi me ngjyra, një përshkrim të qartë të lodrës duke përfshirë dimensionet e saj dhe listën e testeve të kryera së bashku me referimin në raportin e tyre të testeve.

Certifikata EC e shqyrtimit të tipit rishikohet, nëse kërkohet, veçanërisht në rastin e një ndryshimi në procesin e prodhimit, të lëndëve të para ose të komponenteve të lodrës dhe për çdo rast në çdo 5 vjet.

Certifikata e shqyrtimit EC të tipit pezullohet nëse lodra nuk përmbush kërkesat e dhëna në pikën 3 dhe 8.

Organizmat e notifikuar Europian ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri nuk mund të japin certifikatën EC të shqyrtimit të tipit për një lodër që i është refuzuar ose pezulluar një certifikatë nga një organizëm tjetër i i notifikuar.

h) dokumentacioni teknik dhe korespondenca e lidhur me procedurat e shqyrtimit EC të tipit hartohen në një gjuhë zyrtare lehtësisht të kuptueshme të përcaktuar më parë nga struktura përgjegjëse.

4.2.5 Moduli C – Konformiteti me tipin mbështetur në kontrollin e brëndshëm të prodhimit

a) Konformiteti me tipin mbështetur në kontrollin e brëndshëm të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit, ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në nënpikat b) dhe c) të moduli C, siguron dhe deklaron se lodrat janë në konformitet me tipin që përshkruhet në certifikatën EC të shqyrtimit të tipit dhe plotësojnë kërkesat thelbësore në lidhje me to.

b) Prodhuesi merr masat e nevojshme që procesi i prodhimit dhe i kontrollit të tij sigurojnë konformitetin e lodrave të prodhuara me tipin e aprovuar të përshkruar në certifikatën EC të shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat thelbësore në lidhje me to

c) Prodhuesi vendos markimin e konformitetit në çdo lodër që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën EC të shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat thelbësore në lidhje me to. Prodhuesi harton një deklaratë konformiteti për një model lodre dhe e mban atë në dispozicion të

autoriteteve/ministritë dhe strukturës përgjegjëse 10 vjet pas vendosjes në treg të lodrës. Deklarata e konformitetit identifikon modelin e lodrës për të cilën është hartuar. Një kopje e deklaratës së konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë të tyre,
c) detyrimet e lartpërmendura të prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që këto janë specifikuar në mandatin e tij.

4.3. Dokumentacioni teknik

4.3.1. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik i cili përmban të gjitha të dhënat përkatëse mbi mjetet e përdorura nga prodhuesi që sigurojnë se lodrat janë në përputhje me kërkesat e sigurisë referuar në pikat 3 dhe 8.

Në veçanti ai përmban dokumentat e listuara më poshtë:

- a) një përshkrim të detajuar të projektimit/dizajnit dhe prodhimit të lodrës, duke përfshirë listen e komponentëve dhe materialeve të përdorur tek lodra si dhe të dhëna mbi sigurinë e kimikateve të përdorura, që merren nga furnizuesit kimikateve;
- b) vlerësimin/et e sigurisë të kryer në përputhje me pikën 4.2.4 b);
- c) përshkrimin e procedurës së ndjekur për vlerësimin e konformitetit;
- d) kopjen e deklaratës EC të vlerësimit të konformitetit;
- e) adresat e vendeve të prodhimit dhe magazinimit;
- f) kopje të dokumentave që prodhuesi, nëse është i përfshirë, ka dorëzuar tek një organizëm evropian i notifikuar ose degë e tij e regjistruar në Shqipëri;
- g) raportet e testimeve dhe përshkrimin e mënyrave dhe mjeteve me të cilat prodhuesi ka garantuar konformitetin e prodhimit me standardet e harmonizuara, nëse prodhuesi ka zbatuar procedurën e kontrollit të brendshëm të prodhimit si të referuar në pikën 4.2.2; dhe
- h) një kopje të certifikatës EC të shqyrtimit të tipit, një përshkrim të mjeteve dhe mënyrave që prodhuesi garanton konformitetin e prodhimit me tipin e lodrës të përshkruar në certifikatën EC të shqyrtimit të tipit dhe kopje të dokumentave që prodhuesi ka dorëzuar tek organizmi evropian i notifikuar ose degë e tij e regjistruar në Shqipëri, nëse prodhuesi i ka zbatuar shqyrtimin EC të tipit të lodrës dhe procedurën e konformitetit të tipit si të referuar në pikën 4.2.4

4.3.2 Dokumentacioni teknik hartohet në gjuhën e vendit ku është vendosur organizmi evropian i notifikuar ose degë e tij e regjistruar në Shqipëri ose në gjuhën e pranueshme nga ky i fundit

4.3.3. Prodhuesi, sipas një kërkesë të bërë nga Struktura përgjegjëse duhet të bëjë përkthimin në shqip të pjesëve përkatëse të dokumentacionit teknik

Kur struktura përgjegjëse kërkon nga prodhuesi dokumentacionin teknik ose një përkthim të pjesëve të tij, ajo mund të caktojë një afat për marrjen e kësaj dosjeje ose të përkthimit që mund të jetë 30 ditë, përjashtuar rastin e një risku serioz dhe të drejtpërdrejtë ku afati është më i shkurtër.

4.3.4. Nëse prodhuesi nuk plotëson kërkesat e pikave 4.3.1, 4.3.2 dhe 4.3., struktura përgjegjëse mund të kërkojë atij për të bërë një test në një organizëm evropian i notifikuar ose degë e tij e regjistruar në Shqipëri, me shpenzimet e tij dhe brenda një afati kohor të përcaktuar, me qëllim që të verifikojë përputhshmërinë me standardet e harmonizuara dhe me kërkesat thelbësore të sigurisë.

5. Kërkesat e degëve të organizmave evropianë të notifikuar të regjistruara në Shqipëri për të operuar si organe të miratuar (më poshtë referohen si organe të miratuara)



5.1 Organi i miratuar nënkontraktin detyra specifike të lidhura me vlerësimin e konformitetit, ai duhet të sigurohet se veprimtaria e nënkontraktorit ose degës plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 19 të Ligjit nr 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore dhe informon në të njëjtën kohë autoritetin miratues.

5.2 Organi i miratuar merr përgjegjësinë e plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët, kudo ku ata janë të vendosur.

5.3 Çdo veprimtari mund të nënkontraktohet ose të kryhet nga një organ i miratuar vetëm me pëlqimin e klientit.

5.4 Organi i miratuar mban në dispozicion të ministrisë për tregtinë dokumentacionin përkatës në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktorit dhe punën e kryer prej tyre.

5.5. Kërkesa e vlerësimit për të qënë organ i miratuar mund të shoqërohet edhe me një pershkrim të lodrës apo lodrave për të cilat ky organ pretendon se është kompetent

5.6. Vendimi i miratimit mund të përmbajë, përveç sa parashikohet në ligjin 10489, edhe një pershkrim të lodrës apo lodrave përkatëse për të cilat organi miratohet.

5.7. Organet e miratuara kryejnë vlerësimet e konformitetit në përputhje me procedurën e vlerësimit të konformitetit të përcaktuar në pikën 4.2.3.

5.8. Vlerësimet e konformitetit duhet të kryhen në mënyrë proporcionale duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomik. Organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit kryejnë veprimtaritë e tyre duke patur parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin ai vepron, strukturën e saj, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së lodrës në fjalë dhe madhësinë e serisë në procesin e prodhimit.

Gjithsesi, ato duhet të respektojnë shkallën e sigurisë dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar lidhur me përputhshmërinë e lodrës me këtë Rregull Teknik.

5.9. Kur një organ i miratuar gjen se nuk janë plotësuar nga prodhuesi kërkesat thelbësore të sigurisë ose të standardeve përkatës të harmonizuara, ai i kërkon prodhuesit të marrë masat e duhura korrigjuese dhe nuk lëshon certifikatën EC të shqyrtimit të tipit.

5.10. Kur, gjatë monitorimit të përputhshmërisë mbas lëshimit të certifikatës së shqyrtimit EC të tipit, organi i miratuar gjen se një lodër është në mospërputhje, ai i kërkon prodhuesit të marrë masat e duhura korrigjuese dhe, nëse është e nevojshme, pezullon ose tërheq certifikatën e shqyrtimit EC të tipit.

5.11. Nëse nuk janë marrë masat korrigjuese ose kur ato nuk kanë dhënë efektin e kërkuar, organi i miratuar kufizon, pezullon ose tërheq certifikatat përkatëse të shqyrtimit EC të tipit.

5.12 Cdo organ i miratuar siguron për organet e tjerë të miratuar nën këtë Rregull Teknik dhe që kryejnë veprimtari të ngjashme të vlerësimit të konformitetit dhe që mbulojnë të njëjtat lodra, informacionin përkatës mbi rezultatet negative dhe, sipas një kërkesë, edhe rezultatet pozitive të vlerësimit të konformitetit.

6. Bashkëpunim i organeve të miratuara me strukturën përgjegjëse të mbikqyrjes së tregut

6.1. Struktura përgjegjëse e mbikqyrjes së tregut mund t'i kërkojë organit të miratuar informacion në lidhje me çdo certifikatë EC të shqyrtimit të tipi, që ai ka lëshuar ose tërhequr, ose që ka refuzuar të lëshojë, përfshirë raporte të testimit dhe dokumentacionin teknik.

6.2. Nëse struktura përgjegjëse zbulon se një lodër nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë, sipas rastit ajo këshillon organin e miratuar të tërheqë certifikatën EC të shqyrtimit të tipit në lidhje me këtë lodër.

6.3. Sipas rastit, veçanërisht në rastet referuar në gjërmën gj) të pikës 4.2.4, struktura përgjegjëse këshillon organin e miratuar të rishikojë certifikatën EC të tipit.

Lodrat në përputhje me VKM nr 888 datë 18.12.2007 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave” mund të vendosen në treg deri në 1 qershor 2015

7. Lista e produkteve që nuk konsiderohen si lodra brënda kuptimit të këtij Rregulli Teknik

- a) Objekte dekorative për festime.
- b) Produkte për koleksionistë, me kusht që produkti ose ambalazhi i tij të ketë një tregues të dukshëm dhe të lexueshëm se ai është parashikuar për koleksioniste mbi 14 vjeç. Shëmbuj tëkësaj kategorie janë:
 - i) modelime të detajuara dhe të besueshme,
 - ii) kuti me vegla për montimin e modelimeve të detajuara;
 - iii) kukulla folklorike dhe kukulla për zbukurime dhe të tjera të ngjashme me to,
 - iv) lodra si riprodhime historike, dhe
 - v) riprodhime reale të armeve të zjarrit.
- c). Pajisje sportive, duke përfshirë patinat me rula, patinat e sheshta, monopatinat, të parashikuara të përdoren nga fëmijë me një mase trupore mbi 20 kg.
- ç). Bicikleta me lartësi maksimale të shalës më shumë se 435 mm, e matur si dimension vertikal nga toka deri në sipërfaqen e sipërme të shalës në pozicion horizontal dhe ajo është e vendosur në shenjën minimale të tubit mbajtës.
- d). Motoçikleta dhe mjete të tjera transporti të projektuara për sport ose që janë të parashikuara të përdoren për udhetime në rrugë ose rrugina publike.
- e). Mjetet lëvizëse elektrike, të cilat janë të parashikuara të përdoren për të lëvizur në rrugë publike, parqe publike ose në trotuare.
- ë) Pajisjet ujore të parashikuara të përdoren në thellësi ujore dhe mjete për mësimin e notit për fëmijë, si karrige noti dhe ndihmëse për notim.
- f). Pazlla me më shumë se 500 copë.
- g). Armë dhe pistoleta që përdorin gaz të kompresuar (ngjeshur), duke përjashtuar armët dhe pistoletat me ujë dhe harqet mbi 120 cm të gjatë.
- gj). Fishekzjarret, duke përfshirë dhe ato me kapsolla goditëse të cilat specifikisht nuk janë projektuar si lodra.
- j). Produkte dhe lojra që përdorin maja të mprehta, të tilla si grupe shigjetash me maja metalike.
- k). Produkte me funksione edukative, të tilla si soba elektrike, hekura për hekurosje apo produkte të tjera edukative që funksionojnë nën një tension nominal më të madh se 24 volt dhe shiten vetëm për qëllime mësimi nën mbikqyrjen e të rriturve.
- l). Produkte të parashikuara për përdorime në shkollë dhe në kontekste të tjera pedagogjike si pajisje shkencore për qëllime edukimi dhe nën mbikqyrjen e një instruktori të rritur.
- ll). Pajisje elektronike si kompjutera personale dhe tastiera loje të përdorura për të hyrë në software interaktive dhe në periferite shoqëruese të tyre, përveç pajisjeve elektronike ose periferive shoqëruese të tyre që janë specifikisht të projektuara që fëmijët të luajnë dhe që kanë një vlerë loje në tërësinë e tyre dhe që posaçërisht janë konstruktuar si kompjutera personal, stenda, shkopinj loje ose mekanizma drejtimi.
- m). software interaktive të destinuara për kohë të lirë dhe për argetim si lojra kompjuterike me mjetet e tyre të ruajtjes si CD të.
- n). Biberona
- o). Ndriçues tërheqës për fëmijët.



- p). Transformatorët elektrik për lodra.
- q). Aksesorë mode për fëmijë por që nuk përdoren në lojë.

8. Kërkesa të veçanta mbi sigurinë

8.1 Karakteristikat Fizike dhe Mekanike

8.1.1. Lodrat dhe pjesët përbërëse të tyre dhe, në rastin e lodrave të fiksuara, lidhjet e tyre duhet të kenë fortësinë e duhur mekanike dhe, ku kërkohet, qëndrueshmërinë për të përballuar pa risk sforcimet, që lindin gjatë përdorimit dhe që mund të shkaktojnë dëmtime fizike për shkak të këputjeve dhe shtrembërimeve.

8.1.2. Pjesët e mprehta, te ngriturat, kordonët, litarët dhe pjesët e mbërthyer mbi lodra duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që risqet ndaj dëmtimeve fizike nga kontakti me to të jenë të reduktuara mundësisht sa më shumë.

8.1.3. Lodrat duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të mos paraqesin risk ose vetëm një risk të natyrshëm minimal, që mund të shkaktohet nga lëvizja e pjesëve të tyre gjatë përdorimit.

8.1.4a) Lodrat dhe pjesët e tyre nuk duhet të paraqesin risk lidhur me mbytjen.

b) Lodrat dhe pjesët e tyre nuk duhet të paraqesin risk lidhur me bllokimim e rrugëve të frymëmarrjes si rezultat i pengimit të jashtëm të frymëmarrjes nga goja dhe hunda.

c) Lodrat dhe pjesët e tyre duhet të kenë përmasa të tilla, që të mos paraqesin risk në bllokimin e rrugëve të frymëmarrjes si rezultat i pengimit të brendshëm nga gëlltitjet e objekteve në gojë ose grykë.

ç) Lodrat, të cilat qartësisht destinohen të përdoren nga fëmijë nën 36 muaj, dhe pjesët përbërëse të tyre si dhe çdo pjesë e ndashme e tyre duhet të jenë në përmasa të tilla që të parandalojnë gëlltitjen ose marrjen e frymës. Gjithashtu, kjo zbatohet edhe për lodra dhe për pjesët përbërëse të tyre të destinuara të vendosen në gojë.

d) Paketimi në të cilin vendosen lodrat për shitjet me pakicë nuk duhet të paraqesin një risk të lidhur me gëlltitjen ose asfiksimin e shkaktuar nga pengimi jashtëm i rrugëve të frymëmarrjes nga goja ose hunda.

dh) Lodrat e vendosura brënda ushqimeve ose të përziera me ushqime duhet të kenë paketimin e tyre. Ky paketim të jetë në dimensione të tilla që të parandalojë gëlltitjen dhe/ose marrjen e frymës.

e) Paketimi i lodrës, i referuar në paragrafët d) dhe dh), i cili është në formë sferike, vezake ose eliptike, dhe çdo pjesë e ndashme e tij ose paketimi cilindrik i lodrës me funde të rrumbullakta, duhet të jetë në dimensione të tilla që të parandalojnë krijimin e pengesave nga ngecja në gojë ose grykë ose të depozituara në sistemin e frymëmarrjes,

ë) Ndalohet vendosja lodrave shumë ngjeshur në një produkt ushqimor, i tillë që duhet konsumuar produkti ushqimor që të merret kontakt i drejtpërdrejtë me lodrën. Pjesët e lodrave të vendosura direkt në një produkt ushqimor duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në paragrafët c) dhe ç).

8.1.5. Lodrat ujore duhet të projektohen dhe prodhohen që duke marrë parasysh përdorimin e rekomanduar të lodrës, të reduktojnë sa më shumëçdo risk ndaj humbjes së notimit të lodrës ashtu dhe humbjen e mbështetjes të ofruar për fëmijën.

8.1.6. Lodrat, të cilat mundësojnë qëndrimin brënda saj dhe kanë një hapësirë të mbyllur për personat, duhet të kenë një dalje e cila parashikohet të hapet lirshëm nga brënda nga përdoruesi i parashikuar.

8.1.7. Lodrat, që japin lëvizshmëri për përdoruesit e tyre duhet, për aq sa mundësohet, të kenë të përfshirë një sistem frenimi sipas tipit të lodrës dhe që funksionon me energjinë kinetike të gjeneruar nga vetë ai. Sistemi i frenimit duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm nga përdoruesi pa shkaktuar risk gjatë veprimit ose dëmtim fizik për përdoruesin ose palët e treta.

Shpejtësia maksimale e projektuar për lodrat lëvizëse elektrike duhet të jetë e limituar për të zvogëluar riskun e dëmtimit.

8.1.8. Forma dhe përbërja e gazeve shtytës dhe energjia kinetike, që mund të gjenerohet kur del flakë nga një lodër e projektuar për këtë qëllim, duhet të jenë të tilla që, duke marrë parasysh natyrën e lodrës, të mos ketë risk të dëmtimit fizik të përdoruesit ose në palët e treta.

8.1.9. Lodrat duhet të prodhohen në atë mënyrë që të sigurojnë që:

a) temperatura maksimale dhe minimale në çdo sipërfaqe të mos shkaktoje dëmtime kur preket; dhe

b) lëngjet dhe gazet që gjenden brënda lodrës të mos kalojnë temperatura ose presione që, përveç rasteve të domozdoshme për funksionimin e duhur të lodrës, gjatë daljes së tyre mund të shkaktojnë djegje, përvëlime apo dëmtime të tjera fizike.

8.1.10. Lodrat të cilat janë të projektuara të lëshojnë një tingull duhet të projektohen dhe të prodhohen në atë mënyrë që kufiri i vlerave maksimale të impulsit të zhurmës dhe vazhdueshmërisë së zhurmës së tingullit të mos dëmtojë dëgjueshmërinë e fëmijëve.

8.1.11. Lodrat aktivizuese duhet të prodhohen në atë mënyrë që të reduktojnë mundësisht sa më shumë riskun e shtypjes ose të-kapjes të pjesëve të trupit, të rrobave dhe veshjeve, përplasjeve dhe mbytjes.

Në veçanti, çdo sipërfaqe e një lodre të tillë, kur mbi të luajnë një ose më shumë fëmijë, duhet të projektohet që të përballojë peshën e tyre.

8.2. Ndezshmëria

8.2.1. Lodrat nuk duhet të përmbajnë elementë të ndezshëm të rrezikshëm në ambientin e fëmijës. Ato duhet të përbëhen nga materiale që plotësojnë një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

a) të mos digjen nëse ekspozohen direkt në një flakë ose shkëndi ose në një burim tjetër potencial zjarri;

b) të mos jenë lehtësisht të ndezshëm (flaka të largohet më shpejt se të shkaktohet zjarri);

c) nëse ato ndizen, të digjen ngadalë dhe të japin një përhapje të ulët të flakës;

ç) pavarësisht nga përbërja kimike e lodrës, ato projektohen në atë mënyrë që procesi i djegjes të jetë mekanikisht i ngadaltë.

Çdo material i djegshëm nuk duhet të përmbajë një risk të lidhur me ndezjen e materialeve të tjerë të përdorur në lodër.

8.2.2. Lodrat, të cilat për arsye thelbësore të funksionimit të tyre, përmbajnë substanca ose përzjerje që plotësojnë kriteret e klasifikimit të substancave dhe përzierjeve referuar legjislacionit përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike veçanërisht, në materialet dhe pajisjet për eksperimente kimike, montime modelesh, derdhje plastike ose qeramike, emalime, fotografi ose aktivitete të ngjashme, nuk duhet të përmbajnë substanca ose përzjerje që mund të bëhen të ndezeshme për shkak të humbjes së qëndrueshmërisë ndezëse të komponentëve të paqëndrueshëm.

8.2.3. Lodrat, përveç atyre me kapsolla goditëse, nuk duhet të jenë shpërthyes ose të përmbajnë elementë apo substanca që mund të shpërthejnë kur përdoren si është përcaktuar në paragrafin e parë të pikës 3.1b).



8.2.4. Lodrat dhe, në veçanti, lojrat dhe lodrat kimike nuk duhet të përmbajnë substanca apo përzjerje të tilla që:

- a) kur përzihen së bashku mund të shpërthejnë për shkak të një reaksioni kimik ose nëpërmjet ngrohjes;
- b) mund të shpërthejnë kur përzihen me substanca oksiduese, ose
- c) përmbajnë komponentë të paqëndrueshëm të cilët janë të ndezshëm në ajër dhe mundësojnë të formojnë një përzjerje të ndezshme ose një përzjerje shpërthyesë avuj/ajër.

8.3. Vetitë kimike

8.3.1. Lodrat duhet të projektohen dhe të prodhohen në atë mënyrë që të mos kenë risqe me efekte negative për shëndetin për shkak të ekspozimit ndaj substancave apo përzjerjeve kimike me të cilat janë të përbëra lodrat ose që ato përmbajnë, kur lodrat përdoren sipas specifikimit në nënparagrafin e parë të pikës 3.1(b).

Lodrat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar lidhur me disa kategori të produkteve apo të kufizimeve për disa substanca dhe përzjerje kimike.

8.3.2. Lodrat që në vetvete janë substanca apo përzjerje kimike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në lidhje me klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme.

8.3.3 Substancat, që janë klasifikuar si kancerogjene, mutagjene ose toksike për riprodhim (CMR) sipas legjislacionit përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike, ndalohen të përdoren në lodrat, komponentët e tyre si dhe në pjesët dalluese të mini-strukturave.

8.3.4 Përjashtuar pikës 8.3.3, substancat ose përzjerjet e klasifikuara si CMR kategoria 1A dhe 1B, referuar legjislacionit përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike mund të përdoren në lodra, komponentët e tyre si dhe pjesët dalluese të mini-strukturave të tyre kur plotësohet një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

- a) këto substanca dhe përzjerje përmbahen në përqëndrime individuale të barabarta ose më të vogla se përqëndrimet e lejuara që referohen nelegjislacionin përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike
- b) këto substanca dhe përzjerje janë të pakontaktueshme nga fëmijët në çdo lloj mënyre, përfshirë frymëmarrjen, kur lodra përdoret siç përcaktohet në pikën 3.1 b).

8.3.5 Përjashtuar pikës 8.3.3, substancat ose përzjerjet e klasifikuara si CMR kategoria 2, referuar legjislacionit përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike, mund të përdoren në lodra, komponentët e saj apo pjesët dalluese të mini-strukturave të saj, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) këto substanca dhe përzjerje përmbahen në përqëndrime individuale të barabarta ose më të vogla se përqëndrimet lejuara që referohen ne legjislacionin përkatës për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve kimike
- b) këto substanca dhe përzjerje janë të pakontaktueshme nga fëmijët në çdo lloj forme, përfshirë frymëmarrjen, kur lodra përdoret sipas specifikimit në pikën 3.1 b) ose

8.3.6 Pikat 8.3.3, 8.3.4 dhe 8.3.5 nuk zbatohen për nikelin në çelikut inoks

8.3.7 Pa kundërshtuar pikën 8.3.3 dhe 8.3.4, ndalohen nitrosaminat dhe substancat nitrosable të përdoren në lodrat e parashikuara për fëmijë nën 36 muajsh ose në lodra të tjera që parashikohen të futen në gojë nëqoftëse migrimi i substancave është i barabartë ose më i lartë se 0,05mg/kg për nitrosaminat dhe 1mg/kg për substancat nitrosable

8.3.8 Lodrat kozmetike, te tilla si lojë kozmetike për kukullat, duhet të përmbushin kërkesat e lidhura me etiketimin në zbatim të legjislacionin per produktet kozmetike

8.3.9 Lodrat nuk duhet të përmbajne substancat aromatike alergjente të mëposhtme:

No	Emri i aromatizantit alergjike	Numri CAS
(1)	Alanroot oil (Inula helenium)	97676-35-2
(2)	Allylisothiocyanate	57-06-7
(3)	Benzyl cyanide	140-29-4
(4)	4 tert-Butylphenol	98-54-4
(5)	Chenopodium oil	8006-99-3
(6)	Cyclamen alcohol	4756-19-8
(7)	Diethyl maleate	141-05-9
(8)	Dihydrocoumarin	119-84-6
(9)	2,4-Dihydroxy-3-methylbenzaldehyde	6248-20-0
(10)	3,7Dimethyl-2-octen-1-ol(6,7-Dihydrogeraniol)	40607-48 5
(11)	4,6Dimethyl-8-tert-butylcoumarin	17874-34-9
(12)	Dimethyl citraconate	617-54-9
(13)	7,11 Dimethyl-4,6,10-dodecatrien-3-one	26651-96-7
(14)	6,10-Dimethyl-3,5,9-undecatrien-2-one	141-10-6
(15)	Diphenylamine	122-39-4
(16)	Ethyl acrylate	140-88-5
(17)	Fig leaf, fresh and preparations	68916-52-9
(18)	trans-2-Heptenal	18829-55-5
(19)	trans-2-Hexenal diethyl acetal	67746-30-9
(20)	trans-2-Hexenal dimethyl acetal	18318-83-7
(21)	Hydroabietyl alcohol	13393-93-6
(22)	4-Ethoxy-phenol	622-62-8
(23)	6-Isopropyl-2-decahydronaphthalenol	34131-99-2
(24)	7-Methoxycoumarin	531-59-9
(25)	4-Methoxyphenol	150-76-5
(26)	4(p-Methoxyphenyl)-3-butene-2-one	943-88-4
(27)	1-(p-Methoxyphenyl)-1-penten-3-one	104-27-8
(28)	Methyl trans-2-butenolate	623-43-8
(29)	6-Methylcoumarin	92-48-8
(30)	7Methylcoumarin	2445-83-2
(31)	5Methyl-2,3-hexanedione	13706-86-0
(32)	Costus root oil (Saussurea lappa Clarke)	8023-88-9
(33)	7Ethoxy-4-methylcoumarin	87-05-8
(34)	Hexahydrocoumarin	700-82-3
(35)	Peru balsam,crude(Exudation of Myroxylon pereirae (Royle) Klotzsc	8007-00-9
(36)	2-Pentylidene-cyclohexanone	25677-40-1
(37)	3,6,10-Trimethyl-3,5,9-undecatrien-2-one	1117-41-5
(38)	Verbena oil (Lippia citriodora Kunth)	8024-12-2
(39)	Musk ambrette (4-tert-Butyl-3-methoxy-2,6-dinitrotoluene)	83-66-9



(40)	4-Phenyl-3-buten-2-one	122-57-6
(41)	Amyl cinnamal	122-40-7
(42)	Amylcinnamyl alcohol	101-85-9
(43)	Benzyl alcohol	100-51-6
(44)	Benzyl salicylate	18-58-1
(45)	Cinnamyl alcohol	104-54-1
(46)	Cinnamal	104-55-2
(47)	Citral	5392-40-5
(48)	Coumarin	91-64-5
(49)	Eugenol	97-53-0
(50)	Geraniol	106-24-1
(51)	Hydroxy-citronellal	107-75-5
(52)	Hydroxymethylpentylcyclohexenecarboxaldehyde	31906-04-4
(53)	Isoeugenol	97-54-1
(54)	Oakmoss extracts	90028-68-5
(55)	Treemoss extracts	90028-67-4

Megjithatë, lejohet prania e gjurmëve të këtyre substancave aromatike me kusht që një prani e tillë teknikisht është e pashmangëshme në lidhje me praktikën e mirë të prodhimit dhe nuk kalon 100mg/kg.

Përveç kësaj, emrat e substancave aromatike alergjente të mëposhtme duhet të listohen mbi një etiketë të vendosur në lodër ose në paketim, ose nese ka, në fletën shoqëruese të lodres, kur përqendrimit tejkalojnë 100 mg/kg në lodër ose në vetë komponentët:

No	Emri i aromes alergjike	numri CAS
(1)	Anisyl alcohol	105-13-5
(2)	Benzyl benzoate	120-51-4
(3)	Benzyl cinnamate	103-41-3
(4)	Citronellol	106-22-9
(5)	Farnesol	4602-84-0
(6)	Hexyl cinnamaldehyde	101-86-0
(7)	Lilial	80-54-6
(8)	d-Limonene	5989-27-5
(9)	Linalool	78-70-6
(10)	Methyl heptine carbonate	111-12-6
(11)	3-methyl-4-(2,6,6-trimethyl-2-cyclohexen-1-yl)-3-buten-2-one	127-51-5

8.3.10. Përdorimi i substancave aromatike, të përcaktuar në pikat nga 41 deri 55 të listës së dhënë në paragrafin e parë në pikën 7.3.5 dhe në pikat nga 1 deri me 11 të paragrafit të trete të kësaj pike, lejohen në lojrat me nuhatje, kutitë kozmetike dhe lojrat egatimit me kusht që:

- substancat aromatike të jenë qartësisht të etiketuara mbi paketim dhe paketimi të përmbajë paralajmerimin e përcaktuar në pikën 9.2;
- kur është e zbatueshme, produktet e pregatitur nga femijet sipas instruksioneve të përdorimit, perputhen me kërkesat e legjislacionit për produktet kozmetike,

c) nëse është e zbatueshme, këto substanca aromatike përputhen me legjislacionin përkatës për ushqimin.

Lojrat me nuhatje, kutite kozmetike, dhe lojrat e gatimit, nuk duhet të përdoren nga fëmijët nën 36 muaj dhe duhet të jenë në përputhje me pikën 9.1.

8.3.11. Lodrat ose komponentët e lodrave nuk duhet të tejkalojnë limitet e mëposhtme:

Elementi	mg/kg Në të thatë,	mg/kg i thyeshëm,	mg/kg pluhur
Aluminium	5 625	1 406	70 000
Antimony	45	11,3	560
Arsenic	3,8	0,9	47
Barium	4 500	1 125	56 000
Boron	1 200	300	5 000
Cadmium	1,9	0,5	23
Chromium (III)	37,5	9,4	460
Chromium (VI)	0,02	0,005	0,2
Cobalt	10,5	2,6	130
Copper	622,5	156	7 700
Lead	13,5	3,4	160
Manganese	1 200	300	15 000
Mercury	7,5	1,9	94
Nickel	75	18,8	930
Selenium	37,5	9,4	460
Strontium	4 500	1 125	56 000
Tin	15 000	750	180 000
Organic tin	0,9	0,2	12
Zinc	3 750	93	46 000

Këto vlera kufitare nuk duhet të zbatohen për lodrat ose komponentët e lodrave, që për shkak të aksesit, funksionit, volumit ose masës së tyre, përjashtojnë qartësisht çdo rrezik për shkak të thithjes, goditjes, gëlltitjes ose kontaktit të zgjatur me lekurën kur përdoren si të specifikuar në paragrafin e parë të pikës 3.1(b)

8.4. Karakteristikat elektrike

8.4.1. Lodrat nuk duhet të kenë një tension nominal që kalon 24 volt rrymë të vazhduar (CD) ose rrymë alternative (AC), dhe pjesët e tyre vepruese nuk duhet të kalojnë 24 volt (DC) ose voltazh ekuivalent (AC).

Tensionet e brëndshme nuk duhet të kalojnë 24 volt DC ose tensionin ekuivalent AC veçse kur është siguruar se tensioni dhe rryma e kombinuar e krijuar nuk gjeneron ndonjë risk ose goditje të dëmshme elektrike, madje edhe kur lodra është e prishur.

8.4.2. Pjesët e lodrave të cilat janë të lidhura ose që hyjnë në kontakt me një burim energjie që mund të shkaktojë një goditje elektrike, duke përfshirë kabllot ose përçues të tjerë nëpërmjet të cilave rryma elektrike transmetohet në ato pjesë, duhet të jenë plotësisht të izoluar dhe mekanikisht të mbrojtura për të parandaluar riskun e një goditjeje elektrike.



8.4.3. Lodrat elektrike duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të sigurojnë se temperaturat maksimale të arritura në të gjitha sipërfaqet e kontaktushme të mos shkaktojnë djegje kur preken.

8.4.4. Nën kushte të parashikuara difekti, lodrat duhet të sigurojnë mbrojtje përkundrejt rreziqeve elektrike që vijnë nga burimi i energjisë elektrike.

8.4.5. Lodrat elektrike duhet të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme përkundrejt rreziqeve nga zjarri.

8.4.6. Lodrat elektrike duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që fushat elektrike, magjetike dhe elektromanjetike dhe cdo rrezatim tjetër i gjeneruar nga pajisja, të jenë të kufizuara brenda nivelit të nevojshëm të lidhur me funksionimin e lodrës dhe duhet të jenë me një nivel sigurie në përputhje me nivelin teknologjik kohor.

8.4.7. Lodrat, të cilat kanë një sistem elektronik kontrolli duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të funksionojnë të sigurt edhe kur sistemi elektronik fillon të mos funksionojë ose të ketë difekte për shkak të dëmtimit të vetë sistemit ose të një faktori të jashtëm.

8.4.8. Lodrat duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të mos japin ndonjë rrezik ndaj shëndetit ose dëmtimit të syve ose lëkurës nga emetimi i rrezeve lazer ose emetimit të drites (LEDs) ose të çdo lloji tjetër rrezatimi.

8.4.9. Transformatori elektrik i një lodre nuk duhet të jetë pjesë integrale e lodrës.

8.5. Higjena

8.5.1. Lodrat duhet të projektohen dhe prodhohen në atë mënyrë që të plotësojnë kërkesat mbi higjenën dhe pastërtinë me qëllim që të shmangët riskun ndaj infektimit, sëmundjeve ose ndotjes.

8.5.2. Lodra e parashikuara për përdorim nga fëmijë nën 36 muaj duhet të projektohen dhe prodhohet në atë mënyrë që ajo të mund të pastrohet. Një lodër prej tekstili duhet të mundësojë larjen duke përjashtuar rastin kur përmban një mekanizëm që mund të dëmtohet nëse laget. Lodra duhet të plotësojë gjithashtu kërkesat e sigurisë edhe mbasi është pastruar në përputhje me këtë pikë si dhe me instruksionet e prodhuesit.

8.6. Radioaktiviteti

Lodrat duhet të jenë në përputhje lidhur me kërkesat e legjislacionit perkates mbi radioaktivitetin.

8.7. Lista e substancave të mëposhtme CMR dhe përdorimet e lejuara të tyre në përputhje me pikat 7.3.4, 7.3.5 dhe 7.3.6

Substanca	Klasifikimi	Përdorimi i lejuar
Nikel	CMR 2	Në çelëqet inoks

9 Paralajmerimet

9.1. Paralajmërime të përgjithshme

Kufizimet në përdorim të referuara në piken 3.2 (a) duhet të përfshijnë së paku moshën minimale dhe maksimale të përdoruesit dhe, ku kërkohet, aftësinë e përdoruesit, peshën maksimale ose minimale të përdoruesit dhe kërkesën për të siguruar se lodra përdoret vetëm nën mbikqyrjen e një të rrituri.

9.2. Paralajmerimet specifike dhe treguesit mbi masat që merren për përdorimin e disa kategorive të lodrave.

9.2.1. Lodrat që nuk janë parashikuar të përdoren nga fëmijë nën 36 muaj.

Lodrat të cilat mund të jenë të rrezikëshme për fëmijët nën moshën 36 muajsh duhet të kenë një paralajmërim të tillë “Jo e përshtatshme për fëmijë nën 36 muaj” ose “Jo e përshtatshme për fëmijë nën tre vjec” ose një paralajmërim grafik në formën e mëposhtme:



Këto paralajmërimet duhet të shoqërohen me një tregues të shkurtër që mund të jape udhëzimet për përdorim lidhur me një rrezik të veçantë dhe që kërkon këtë masë paraprake.

Kjo pikë nuk zbatohet për lodra që për shkak të funksionit, dimesioneve, karakteristikave apo vecorive të tyre, ose për arsye të tjera bindëse, tregojnë qartësisht se janë të papërshtatshme për fëmijë nën 36 muaj.

9.2.2. Lodrat aktivizuese

Lodrat aktivizuese duhet të kenë paralajmërimin e mëposhtëm:

“Vetëm për përdorim shtëpiak”

Lodrat aktivizuese të fiksuara në një traversë si dhe çdolodër tjetër aktivizuese, sipas rastit, duhet të shoqërohet nga instruksione që tërheqin vëmendjen për të kryer kontrolle dhëmirembajtje të pjesëve kryesore (varëse, fiksime, ankorime, etj) në intervale kohore dhe tregues që, nëse këto kontrolle nuk kryen, lodra mund të shkaktojë një rënie ose rrëzim.

Instrukcionet gjithashtu duhet të japin montimin korrekt të lodrës duke treguar pjesët që mund të paraqesin një rrezik nëse nuk montohen korrekësisht. Gjithashtu duhet të jepet një informacion i veçantë lidhur me sipërfaqen e përshtatshme mbi të cilën vendoset lodra.

9.3 Lodra funksionale

Lodrat funksionale duhet të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“Të përdoren vetëm nën mbikqyrjen direkte të një të rrituri”.

Përveç kësaj, këto lodra duhet të shoqërohen me udhëzime të specifikuar që japin instruksionet e punës si dhe masat që merren nga përdoruesi lidhur me paralajmërimin për rrezikun që ekspozohen nëse këto masa nuk merren nga përdoruesidhe normalisht shoqërohen me aplikimin ose produktin e të cilit lodra është në një shkallë modeli ose imitimi. Gjithashtu tregohet se lodra duhet të mbahet larg fëmijëve të një moshe të caktuar, e cila duhet të specifikohet nga prodhuesi.

9.4. Lodrat kimike.

Pa shkelur zbatimin e dispozitave të përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm mbi klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave ose përzjerjeve kimike, instruksionet e përdorimit për lodrat që përmbajnë substanca të rrezikshme ose përzjerje duhet të kenë të vendosur një paralajmërim mbi natyrën e rrezikut e këtyre substancave ose përzjerjeve dhe një udhëzim mbi masat që merren nga përdoruesi me qëllim që të shmangen rreziqet që shoqërojnë ato dhe që specifikohen në mënyrë konçize sipas tipit të lodrës.



Gjithashtu duhet të shpjegohet ndihma e parë që jepet në rastin e një aksidenti serioz që rezulton nga përdorimi i këtij tipi të lodrës. Gjithashtu deklarohet që lodra duhet të mbahet larg nga fëmijë nën një moshë e cila duhet të specifikohet nga prodhuesi.

Përveç treguesëve të përmendur në paragrafin e mësipërm, lodrat kimike duhet të kenë të vendosur në paketimin e tyre paralajmërimin e mëposhtëm:

“Jo i përshtatshëm për fëmijë nën (*) vjec. Për përdorim nën mbikqyrjen e një të rrituri”.

Në veçanti, konsiderohen si lodra kimike:

komplete kimike, komplete plastike për mbjellje, punishte në miniaturë për qeramikë, emalim ose fotografi dhe lodra të ngjashme të cilat krijojnë një reaksion kimik ose një ndryshim të një substance gjatë përdorimit.

9.5. Patina, patina me rula, patina lineare, patina të harkuara (skateboards), monopatina (scooters) dhe biçikleta për fëmijë

Kur këto lodra ofrohen për shitje si lodra, ato duhet të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“Të vishen pajisje mbrojtëse. Jo për përdorim në trafik”.

Për më tepër, instruksionet e përdorimit duhet të përmbajnë një kujtesë që lodra të përdoret me kujdes sepse kërkon aftësi të madhe si për të shmangur dëmtimet ashtu dhe goditjet e shkaktuara tek përdoruesi ose tek palët e treta.

Gjithashtu duhet të jepen disa tregues që rekomandojnë pajisjet mbrojtëse (helmeta, doreza, mbrojtëse gjuri, mbrojtëse bryli etj).

9.6. Lodrat ujore

Lodrat ujore duhet të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“Për përdorim vetëm kur fëmija është në ujë në një thellësi sa trupi i tij dhe nën mbikqyrjen e një të rrituri”.

9.7. Lodrat në ushqime

Lodrat që gjenden në ushqime ose të përzjera me to duhet të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“Ka lodër brenda. Rekomandohet mbikqyrje nga një i rritur”.

9.8. Imitime të maskave dhe helmetave mbrojtëse

Imitimet e maskave dhe helmetave mbrojtëse duhet të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“Kjo lodër nuk ofron mbrojtje”.

9.9. Lodra të parashikuara të lidhen në krevate, djepe ose karroca fëmijësh me anë të spangos, kordonave, llastiqeve ose rripave.

Lodrat e parashikuara të lidhen në krevate, djepe ose karroca fëmijësh me anë të spangos, kordonave, llastikut ose rripave duhet të kenë të vendosur në mënyrë të paheqëshme në paketim paralajmërimin e mëposhtëm, i cili gjithashtu duhet të vendoset në mënyrë të paheqëshme mbi lodër:

“Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm nga çdo ngatërrese, lëvizje këtë loder kur fëmija fillon të përpiqet të zvarritet me duar dhe gjunjë”.

(*) Mosha specifikohet nga prodhuesi.

9.10. Paketimi për lojrat aromatike me nuhatje, kutitë kozmetike dhe lojrat e gatimit

Paketimi për lojrat aromatike me nuhatje, kutitë kozmetike dhe lojrat e gatimit që përmbajnë aromatizantë të dhënë nga nr 41 deri nënr 55 në listën e përcaktuar në pikën 7.3.5 dhe aromatizantë nga nr 1 deri ne 11 të përcaktuar në paragrafin e tretë të kësaj pike të kenë të vendosur paralajmërimin e mëposhtëm:

“ Permban aromatizantë që mund të shkaktojnë alergji”.

VENDIM

Nr. 263, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇAKMAKËVE REZISTENTË NDAJ FËMIJËVE DHE
ÇAKMAKËVE ME MODELE IMITUESE, TËRHEQËS NDAJ FËMIJËVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalimin e vendosjes në treg dhe ofrimit të konsumatorët të çakmakëve me modele imituese, tërheqës ndaj fëmijëve, si dhe garantimin e vendosjes në treg dhe ofrimit të konsumatorët vetëm të çakmakëve rezistentë ndaj fëmijëve.

2. Për qëllim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm kuptojmë:

2.1 “Çakmak”, çdo pajisje, e cila aktivizohet në mënyrë manuale, për të prodhuar flakë me anë të përdorimit të lëndës djegëse, që gjendet në një përmbajtës të trupëzuar, pavarësisht nëse mund të rimbushet ose jo, dhe që kryesisht përdoret për ndezjen e cigareve, purove, pipave apo mund të përdoret për ndezjen e materialeve të tilla si: letër, fitil, qiri dhe fenerë.

2.2 Pa kundërshtuar pikën 1 të këtij vendimi, përkufizimi i dhënë në pikën 2.1 të këtij vendimi nuk zbatohet për çakmakët me rimbushje, me kushtin që prodhuesit, me kërkesë të strukturës përgjegjëse, sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm, që provon se çakmakët janë dizenuar, prodhuar dhe vendosur në treg, të tillë që të garantojnë në përdorim, sigurinë e pritur e të vazhdueshme për jetëgjatësinë e tij, të paktën për një periudhë pesëvjeçare, e të jenë objekt riparimi.

Këta çakmakë me rimbushje duhet të përmbushin kërkesat në vijim:

i) të kenë garanci me shkrim nga ana e prodhuesit, për çdo çakmak, për një periudhë, të paktën 2-vjeçare, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve;

ii) të kenë mundësi praktike për t’u riparuar dhe rimbushur gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre, përfshirë në veçanti mekanizmin ndezës të riparueshëm;

iii) për pjesët që nuk konsumohen, por që kanë mundësi të amortizohen apo prishen gjatë përdorimit të vazhdueshëm pas periudhës së garancisë, të sigurojnë mundësinë e zëvendësimit ose riparimit në qendra të autorizuara ose të specializuara për shërbime pas shitjes.

2.3 “Çakmak me model imitues, tërheqës ndaj fëmijëve” është çdo pajisje që prodhon flakë, i përdorur zakonisht nga konsumatorët për të ndezur cigaret, puot dhe pipat, përfshirë çdo mbajtës

¹ Vendimin e Komisionit Europian 2006/502/EC, të datës 11 maj 2006 “Kërkesë shteteve anëtare për marrjen e masave për të garantuar që të vendosen në treg vetëm çakmakët, të cilët janë rezistentë ndaj fëmijëve dhe të ndalohet vendosja në treg e çakmakëve me modele imituese”, numri Celex 32006D0502, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 198, datë 20.7.2006, faqe 004-0045.



që mund të trupëzohet më vonë ose çdo pjesë shtesë, e cila mund të vendoset/fiksohet më vonë, që i ngjan në çdo lloj mënyre një objekti tjetër që:

- i) është i njohur përgjithësisht si tërheqës; ose
- ii) i parashikuar për përdorim nga fëmijë më të vegjël se 51-muajsh; ose
- iii) që kanë efekte zbavitëse audio apo efekte të animuara.

Një çakmak tërheqës për fëmijët mund të operojë me çdo lloj lënde djegëse, duke përfshirë butanin edhe lëndët djegëse të lëngshme.

Këtu përfshihen, kryesisht, çakmakët ose mbajtësit, që janë qartësisht të parashikuar për të mbajtur, çakmakët, forma e të cilëve u ngjan personazheve të filmave të animuar, lodrave, armëve, orëve, telefonave, instrumenteve muzikore, makinave, trupit të njeriut ose pjesëve të tij, kafshëve, produkteve ushqimore apo pijeve, ose që luajnë nota muzikore apo kanë drita që ndizen, ose objekte që lëvizin a karakteristika të tjera zbavitëse.

Përfshihen çakmakët që janë të stampuar ose janë të zbukuruar me logo, etiketa, dekoracione me ngjytës, vepra arti ose mbështjellëse termoizoluese.

2.4 “Çakmak rezistent ndaj fëmijëve”, një çakmak i dizajnuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që në kushte normale apo të parashikuara të përdorimit nuk mund të përdoret nga fëmijët më të vegjël se 51-muajsh, për shkak të forcës që duhet për t’i përdorur, të dizajnit e mekanizmit ndezës, si dhe kompleksitetit të veprimeve të nevojshme për ndezjen e tyre.

2.5 “Model çakmaku”, çakmakët e prodhuar nga i njëjti prodhues, të cilët nuk ndryshojnë në dizajn apo karakteristika të tjera, në asnjë lloj mënyre që mund të ndikojë në rezistencën ndaj fëmijëve.

2.6 “Test rezistence ndaj fëmijëve”, një test sistematik rezistence ndaj fëmijëve, i një modeli të caktuar çakmaku, mbi një mostër çakmakësh. Këto teste bëhen në përputhje me standardin S SH EN 13869:2002+A1:2011, sipas specifikimeve përkatëse të tij, me përjashtim të atyre të përcaktuara në paragrafët 3.1, 3.4 dhe 5.2.3 të këtij standardi, ose në përputhje me kërkesat e testimit me rregullat përkatëse të shteteve të tjera, të cilat janë të njëjta me kërkesat e rezistencës ndaj fëmijëve, të përcaktuar në këtë vendim.

2.7 “Organ i vlerësimit të konformitetit”, çdo organ sipas përkufizimit të pikës 12 të nenit 3 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.”.

3. Presumohen të jenë rezistentë ndaj fëmijëve çakmakët që janë në përputhje me:

a) standardin S SH EN 13869:2002+A1:2011, sipas specifikimeve të tij, me përjashtim të atyre të përcaktuara në paragrafët 3.1, 3.4 dhe 5.2.3 të këtij standardi; ose

b) kërkesat e testimit me rregullat përkatëse të shteteve të tjera, të cilat janë të njëjta me kërkesat e rezistencës ndaj fëmijëve, të përcaktuar në këtë vendim.

4. Struktura përgjegjëse kërkon nga prodhuesit plotësimin e kërkesave të mëposhtme, si kusht për vendosjen në treg të çakmakëve:

a) mbajtjen dhe vënien menjëherë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të raportit për testin e rezistencës ndaj fëmijëve, për çdo model çakmaku, me mostrat e çakmakëve të testuar, që vërteton/certifikon se modelet e çakmakëve të vendosura në treg janë rezistentë ndaj fëmijëve;

b) vërtetimin/dëshminë që të gjithë çakmakët në secilën seri të tyre të vendosur në treg, janë në përputhje me modelin e testuar dhe, me kërkesë të strukturës, të sigurojnë dokumentacionin e testimit dhe programin e kontrollit që mbështet këtë vërtetim;

c) monitorimin në vazhdimësi të konformitetit të çakmakëve të prodhuar me zgjidhjet teknike që sigurojnë rezistencën ndaj fëmijëve, duke përdorur metodat e përshtatshme të testimit dhe mbajtjen në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut të modelit të testuar. Të dhëna apo regjistra për prodhimin, që janë të domosdoshme për të treguar që të gjithë çakmakët e vendosur në treg janë në konformitet me modelin e testuar;

ç) mbajtjen dhe vënien menjëherë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të raportit të ri të testit të rezistencës ndaj fëmijëve, në rast të çdo ndryshimi të bërë në modelin e çakmakut, që mund të ndikojë negativisht në plotësimin e kërkesave të këtij vendimi nga modeli i ndryshuar apo modifikuar.

5. Struktura përgjegjëse kërkon nga shpërndarësit të mbajnë dhe të sigurojnë menjëherë dokumentacionin e nevojshëm që bën të mundur identifikimin e çdo personi prej të cilit ata janë furnizuar me çakmakët që kanë vendosur në treg, në mënyrë që të sigurohet gjurmueshmëria e prodhuesve të çakmakëve nëpërmjet zinxhirit të furnizimit.

6. Në rastet kur prodhuesit dhe shpërndarësit nuk sigurojnë dokumentacionin e përmendur në pikat 4 dhe 5, brenda afatit kohor të vendosur nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, kjo e fundit kërkon me urdhër me shkrim, ndalimin dhe tërheqjen nga tregu të çakmakëve.

7. Raportet e testeve për rezistencën ndaj fëmijëve, referuar pikës 4 të këtij vendimi përfshijnë në veçanti:

a) emrin, adresën dhe qendrën/selinë kryesore të biznesit të prodhuesit, kudo që ndodhet, dhe të importuesit, në rastin kur çakmaku është i importuar;

b) një përshkrim të plotë të çakmakut, përfshirë: madhësinë, formën, peshën, lëndën djegëse, kapacitetin e lëndës djegëse, mekanizmin e ndezjes dhe pjesët e rezistencës ndaj fëmijëve, dizajnin/projektin, zgjidhjet teknike dhe karakteristika të tjera që e bëjnë çakmakun rezistent ndaj fëmijëve, në përputhje me përkufizimet e kërkesat e këtij vendimi.

Në veçanti, në raportet e testimi përfshihet një përshkrim i hollësishëm i të gjitha përmasave, kërkesave të forcës ose karakteristika të tjera, të cilat mund të ndikojnë në rezistencën ndaj fëmijëve të çakmakut, duke përfshirë dhe tolerancat e prodhuesit për secilën përmasë:

i) një përshkrim të hollësishëm të testeve dhe të rezultateve të marra, vendin dhe datat e kryerjes së testeve, identitetin e organit të vlerësimit të konformitetit që ka kryer testet, si edhe hollësitë e kualifikimit dhe kompetencat e këtij organi për kryerjen e këtyre testeve;

ii) identifikim të vendit ku janë ose kanë qenë fabrikuar çakmakët;

iii) identifikim të vendit ku mbahet dokumentacioni i kërkuar nga ky vendim;

iv) referencat e akreditimit ose të njohjes së organit të testimi.

8. Raportet e testeve të rezistencës ndaj fëmijëve, referuar pikës 5 të këtij vendimi, njihen dhe pranohen kur janë lëshuar nga laboratorë testues të akredituar për kryerjen e këtyre testeve, nga një organ akreditues, nënshkrues i marrëveshjeve shumëpalëshe të njohjes reciproke me Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e laboratorëve dhe/ose me organizatën europiane për akreditimin në fushën e testimi, në përputhje me standardin S SH EN ISO/IEC 17025:2005 “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues”.

9. Ngarkohet struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, e parashikuar në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore, për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohen autoritet doganore për të siguruar ndalimin e eksportit dhe importit të çakmakëve me modele imituese dhe njoftimin e strukturës përgjegjëse, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 265, datë 3.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 934, DATË 26.12.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 934, datë 26.12.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 948 punonjës. Shtesa prej 7 (shtatë) punonjësish është e detajuar sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të institucionit, për vitin 2013.

3. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 1 të pikës 1 të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të përcaktuara me vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 4

Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore (deri në.....)	Periudhë kohore
Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1			
Aparati	1	Sanitare	5 orë	vjetore
Ministria e Jashtme	1			
Aparati	1	Preperatore	5 orë	vjetore
Ministria e Brendshme	3			
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	3	Teknik	8 orë	prill-qershor
Prokuroria e Përgjithshme	1			
Prokuroria e Apelit Shkodër	1	Sanitare	5 orë	vjetore
Ministria e Financave	1			
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	1	Protokollist	5 orë	vjetore
Total punonjës me kontratë	7			

VENDIM
Nr. 266, datë 3.4.2013

**PËR PAGESËN E KËSTIT TË PESTË TË SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN
DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/24
“MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM PRODUCTS SOCIETE ANONYME S.A.
KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi 122 500 (njëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i pestë), për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/24 “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme S.A., kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet (ICSID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 267, datë 3.4.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 24, DATË 9.1.2013 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË,
TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN
AKADEMIK 2012-2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 24, datë 9.1.2013 të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2012-2013, gjithsej 1320, të ndara si më poshtë vijon:



- a. për kandidatët brenda territorit të vendit 1155;
b. për kandidatët nga trojet jashtë kufijve të vendit 155;
c. për shtetasit e huaj 10.

b) Emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës “Metodat sasiore dhe të informacionit”, me numër rendor 33, në tabelën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, ndryshohet dhe bëhet “Sistemet e informacionit në ekonomi”.

c) Tabelës nr. 1, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr. 1

Universiteti	ID Programi	Emërtimi i programit	Kuota për kandidatët brenda vendit	Kuota për kandidatët nga trojet
Universiteti i Tiranës	93	Gazetari	14	1

VENDIM
Nr. 268, datë 3.4.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDË PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, shpenzime kapitale, pakësohet fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, shtohet fondi prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 271, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË MENAXHIMIT, OPERIMIT, MIRËMBAJTJES DHE PËRMIRËSIMIT
TEKNIK TË TERMINALIT TË TRAGETEVE NË PORTIN E DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1 e 3, e 16 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të trageteve në Portin e Durrësit është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni do të jetë një koncesion shërbimi si propozim i kërkuar i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 272, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN PËR
PËRDORIM ME KONCESION TË BURIMIT UJOR SASAJ” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË “BLUE EYE ONE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, dhe 23 pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie për përdorim me koncesion të burimit ujor “Sasaj”, është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8,5% të pikave, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Blue eye one”.
4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 18.4.2013
Doli nga shtypi më 18.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë